



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.

Prishtinë, më 10.02.2010, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikoliç, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Suzana Novobërdaliu, Haki Shatri, Besa Gaxheri, Mufera Sinik dhe Xhevdet Neziraj

Mungoj Hajdin Abazi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe Teki Shala, Ramadan Islami si dhe monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI,

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Natasha Prica Tisma, Ahtere Loxha dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci – Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;

2. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
3. Shqyrtimi i Vendimi i Qeverisë së Kosovës për blerjen e Vaksinave;
4. Shqyrtim i Projektligjit për Hetim Parlamentar me raportet e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
5. Shqyrtim i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës me raportet e Komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente;
6. Shqyrtim i kërkesës së ZRRUM-it për Taksën Vjetore të Licencimit për vitin 2010;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;

Kryesuesi theksoi se ky Projektligj ka pasur një rrugëtim të gjatë, është përcjell nga zyra në zyrë dhe prapë i është kthye Kuvendit.

Mendon se pasqyra financiare rreth kostos së Projektligjit, është e përballeshme për tu miratua dhe implementua , vlerëson se amendamentet e Komisionit funksional janë punuar mirë, duke filluar prej preambulës e cila është rregulluar sepse kur është hartua ky Projektligj Kosova nuk ka qenë e pa varur dhe nuk ka pas Kushtetutë por vetëm Kornizën Kushtetuese dhe të gjitha rregullat që kanë qenë të bazuara në Kornizën Kushtetuese në kohën e administrimit të UNMIK-ut janë përmirësuar , por janë disa çështje duhet diskutuar në Komision.

Hapi diskutimin lidhur me Projektligjin dhe amendamentet e Komisionit funksional dhe kërkoj nga anëtarët ti paraqesin vërejtjet nëse kanë në projektligj.

Filluan shqyrtimin e Projektligjit dhe amendamenteve nen për nen, propozimet për ndryshime filluan nga kryesuesi për nenin 14 , anëtarët dhanë vërejtje edhe në nenet tjera .

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve të dhëna nga anëtarët , kryesuesi i Komisionit nxori këtë ;

Përfundim

Komisioni Shqyrtoj projektligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësit e Deputetit, duke konstatuar se dispozitat e këtij projektligji nuk përmbajnë implikime buxhetore

Komisioni shqyrtoj raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente ,*dha disa vërejtje për ndryshime të cilat në mbledhjen e ardhshme do ti shqyrtoj edhe një herë dhe do të dal me rekomandime për Kuvendin.*

3.Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Kosovës për blerjen e Vaksinave

Kryesuesi theksoi se këtë kërkesë nuk janë kërkuar mjete shtesë, por shitësi i vaksinave kërkon vendim të Kuvendit që ti epet avansi i plotë sepse Ligji për Menaxhimin e Financave publike nuk e rregullon këtë çështje,në këtë rast kërkohet vendimi i Kuvendit që ti lejohet ti i pet avansi i plotë .

Pasi nuk kishte anëtar që ishin kundër

Kryesuesi konstatoj se një zëri Komisioni nxori këtë :

R e k o m a n d i m

1. Miratohet Vendimi i Qeverisë për lejimin e pagesës (avansit) në shumën prej 635.756,40 €për furnizim me vakcina, sipas Marrëveshjes së nënshkruar në mes të UNICEF-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë për Programin e zgjëruar për imunitet.

4.Shqyrtim i Projektligjit për Hetim Parlamentar me raportet e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Projektligjin.

Pasi nuk kishte vërejtje nga anëtarët

Kryesuesi konstatoj se Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar projektligjin për Hetim Parlamentar dhe ka konstatuar se dispozitat e këtij projektligji nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar amendamentet e Komisionit funksional-Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi duke konstatuar se amendamentet nuk

përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratoj projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtim i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës me raportet e Komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente;

Kryesuesi vlerësoi se ky projektligj përmban implikime buxhetore dhe nuk është paraparë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve , një ligj i tillë është i nevojshëm dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Pas diskutimeve të anëtarëve Komisioni nxori këtë;

Rekomandim

I. Komisioni për Buxhet e Financa e shqyrtoi P/ligjin për diasporën e Kosovës nr.03/L-171, dhe konstatoi se amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional përmbajnë implikime buxhetore dhe nuk është parapr në Kornizën afatmesme të shpenzimeve .

II. Në pajtim me këtë, Komisioni për Buxhet e Financa kërkon nga komisioni funksional të vijë në mbledhje të Komisionit dhe së bashku me përfaqësuesit e ministrisë (Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, Kulturës, Rinisë e Sportit) , t'i rishqyrtojë dispozitat e P/ligjit dhe amendamentet të cilat përmbajnë implikime buxhetore .

Shqyrtim i kërkesës së ZRRUM-it për Taksen Vjetore të Licensimit për vitin 2010

Kryesuesi konstatoj se kërkesa e ZRRUM-it përmban disa paqartësi dhe propozoj që të ftohet në mbledhjen tjetër përfaqësuesi i këtij institucioni që të sqaroj në mënyrë më të detajuar.

Pasi nuk u kundërshtua nga anëtarët Kryesuesi nxori këtë :

Përfundim

Në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e ZRRUM-it për të diskutuar më detajisht lidhur me kërkesën dhe pastaj Komisioni të del me rekomandim .

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisioneve.

Kryesuesi i Komisionit

Gani Koci

